



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivered	12. 04. 2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlopja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/TK	1730/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.116/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.116/2021, të datës 02.03.2021, të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit KA.nr.09/2021 të datës 16.02.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen administrative-juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 12.04.2021, unanimisht mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.116/2021 e datës 02.03.2021, e parashtruar nga ankuesja.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.09/2021 i datës 16.02.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja Bashkëpunëtoare Profesionale në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega në Klinë, më datë 02.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 889/2021 të regjistruar me numër A.nr. 116/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.09/2021 të datës 16.02.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.03.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit të Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 29.03.2021 ka pranuar përgjigjen në kërkesë me numër protokoli 1446/2021 së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.116/2021 të datës 02.03.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 10.03.2021; Vendimin KA.nr.09/2021 të datës 16.02.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës DS-26/2021 të datës 18.01.2021; Pliko me numër R1466857 të datës 26.02.2021; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1446/2021 të datës 29.03.2021; Ankesën me numër protokolli 01/188 drejtuar Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës - Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të datës 03.02.2021; Akt Emërim i datës 07.04.2014; Certifikatë për provimin e dhënë të Jurisprudencës i datës 21.05.2005; E-mail nga S.B. për B.G. i datës 13.01.2021; E-mail nga B.G. për S.B. i datës 13.01.2021; E-mail nga S.B. për B.G. i datës 13.01.2021; Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile i datës 13.01.2021; Certifikatë e Vdekjes e datës 12.11.2020; E-mail nga C.Z. për F.E. i datës 29.03.2021; E-mail nga F.E. për C.Z. i datës 29.03.2021; E-mail nga F.E. për C.Z. i datës 29.03.2021; Deklaratë për Bashkësinë Familjare i datës 29.03.2021; E-mail nga F.K. për C.Z. i datës 31.03.2021; E-mail nga B.G. për F.K. i datës 31.03.2021; E-mail nga S.B. për B.G. i datës 13.01.2021; E-mail nga B.G. për S.B. i datës 13.01.2021; E-mail nga S.B. për B.G. i datës 11.01.2021; E-mail nga F.E. për S.B. 11.01.2021;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka vlerësuar së janë plotësuar kushtet për pranushmerinë e ankesës dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht sipas Akt Emërimit me Nr.Ref: 03/137 të datës 07.04.2014, Kolegji ka gjetur se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës Bashkëpunëtore Profesionale në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega në Klinë.

Ankuesja me datë 13.01.2021 ka parashtruar pranë Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (me tej SKGJK), kërkesë për ndihmë me rastin e vdekjes së vëllait të saj. Në Përgjigje ndaj kërkesës së ankueses të datës 13.01.2021, Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së me Vendimin DS-26/2021 të datës 18.01.2021, ka refuzuar kërkesën e ankuesit për ndihmë në rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes. Kundër këtij Vendimi, ankuesja me datë 03.02.2021 ka ushtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ku i njëjti me Vendimin KA.nr.09/2021 të datës 16.02.2021, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Vendimi KA.nr.09/2021 i datës 16.02.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, është në kundërshtim me nenin 18 pika 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ 2014/02 për Përcaktimin e Procedurave për Realizimin e Shtesave mbi Pagën dhe Kompensimet tjera të nëpunësve civil në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Propozon që Këshilli ti njeh të drejtën e kompensimit të një shumë monetare në vlerën e një page mesatare me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave lidhur me pretendimin ankimor të ankueses ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22, ku përcaktohet se: 2. Nëpunësit civil, kanë të drejtat në vijim; 2.4 ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësit civil; si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve

Civil, përkatësisht nenin 22, ku përcaktohet se: 2. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil, në rast të vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, nëpunësi civil gëzon të drejtën e ndihmës institucionale, përmes kompensimit të një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave gjatë analizimit të Udhëzimit Administrativ 2014/02 për Përcaktimin e Procedurave për Realizimin e Shtesave mbi Pagën dhe Kompensimet tjera të nëpunësve civil në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ka gjetur se neni 18 i këtij Udhëzimi ka përcaktuar të drejtën e kompensimit të një page mujore për familjen në rast të vdekjes së nëpunësit civil, e jo kompensimin e nëpunësit civil në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, andaj Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për njohjen e së drejtës së kompensimit të një shumë monetare në vlerën e një page mesatare me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, duke u thirrur në nenin 18 të Udhëzimit Administrativ 2014/02 për Përcaktimin e Procedurave për Realizimin e Shtesave mbi Pagën dhe Kompensimet tjera të nëpunësve civil në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, është i pa bazuar.

Ndërsa lidhur me faktin se kush përbënë familjen, Kolegji për shqyrtimin e ankesave i është referuar dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës lidhur me përkufizimin e bashkësisë familjare, ku në nenin 271 përcaktohet se: *Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji.* Çështja e përkufizimit të familjes sipas dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, është konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit të Kosovës, në Aktgjykimin A.A.nr.14/2017.

Andaj, bazuar në shkresat e lëndës respektivisht certifikatat e gjendjes civile, Kolegji ka konstatuar se i ndjeri ka qenë vëlla i ankueses, ndërsa ankuesja ka statusin e martuar dhe pasi që në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se ankuesja ka qenë duke jetuar në bashkësi familjare me të ndjerin apo ka ndarë ekonomi të përbashkët me të, Kolegji vlerëson së pretendimi ankimor i ankueses për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbim Civil, është i pa bazuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.116/2021.

Çlirim Zeka

Zeka
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

